



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-3746/26 datë:13.02.2026



Npi – 01/26 datë: 13.02.2026

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.1 pika 5 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës: 27.04.2023, për mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Shtimes të mbajtur më: 17.02.2026 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E mbajtur më: 17.02.2026, (e martë) në ora 09:00h. në sallën e Kuvendit, me rastin e 18 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë të Republikës së Kosovës më 17.02.2008.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Rrahman Jakupi, Antarët e Kuvendit: z.Grejtalb Emini, z.Besnik Seferi, z.Zenel Shabani, z.Artan Lubovci, z.Faruk Beqa, znj.Uskana Deliu, znj.Adalina Shabani, z.Demokrat Mujota, z.Faik Ramadani, znj.Albana Podvorica, znj.Fatlinda Rrafshi, znj.Arbresha Sylja, z.Bajram Hajrizi, z.Haqif Arifi, z.Shefqet Krasniqi, znj.Frosina Berisha-Ahmeti, znj.Erza Salija, z.Atdhe Isufi, z.Muhamet Ademaj. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe Nënkryetari z.Adnan Ademi, Shefja e Kabinetit znj.Anita Kurti, Drejtorët, Komandanti i Policisë në Shtime z.Haxhi Behluli, Drejtori i QKMF-së z.Ilaz Kadrijaj, Kryetari i fshatit Reçak, z.Adem Ramadani, Përfaqësuesi i BIK në Shtime Imami z.Skender Baftiu. Përfaqësues të Institucioneve lokale. Përfaqësues dhe familjarë të SHFD, SHIL dhe OVL të UÇK-së të Komunës së Shtimes. Zyrtarë Komunal, si dhe qytetarë të tjerë. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Rrahman Jakupi i cili i njoftoi të pranishmit me:

REND DITE

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit,
2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës,
3. Përfaqësues të subjekteve politike në Kuvend,
4. Përfaqësues nga OVL e UÇK-së.

Pika 1

Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj! Ju ftoj që të ngriheni në këmbë me rastin e intonimit të himnit kombëtar dhe shtetëror. Të nderuar qytetarë të Komunës së Shtimes, ju anëtarë të Kuvendit që jeni prezent, i nderuar Nënkryetar i Komunës, të nderuara familje të dëshmorëve, veteranë dhe invalidë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i nderuar Kryetar i Bashkësisë Islame në Shtime, i nderuar Komandant i Stacionit Policor në Shtime, i nderuar baci Isak Asllani, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, zoti Muhamet Bilalli, ju të gjithë që jeni prezent, komandantë të luftës së UÇK-së të zonës së Nerodimes, zyrtarë dhe ish zyrtarë, kryetari i fshatit Reçak dhe ju banorë të fshatit Reçak, mirë se keni ardhur në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës, kushtuar shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës. Mbledhje e cila

po mbahet sot dhe me këtë ne nuk po festojmë vetëm një datë, mirëpo ne po kujtojmë një rrugë të gjatë, e cila ka qenë e dhimbshme dhe lavdishme drejt lirisë, për ndërtimin e shtetit tonë. Të nderuar të pranishëm, ky rrugëtim nuk ka filluar vetëm me shpalljen e pavarësisë, por ka filluar në momentin kur qytetarët e Republikës së Kosovës i thanë jo robërisë. Ky rrugëtim ka filluar me gjyshërit tanë, që sakrifikuan për dinjitet. Ka filluar me prindërit tanë, që qëndruan të pathyeshëm përballë padrejtësive. Ka filluar me nënat tona që rritën fëmijë të lirë, edhe kur frika trokiste në derë të secilit prej nesh. Ky rrugëtim ka filluar me rezistencën paqësore, ka filluar me mësimin nëpër shtëpi, ka filluar me studentët që protestonin paqësisht dhe me qytetarët të cilët nuk pranuan të përkulen. Por mbi të gjitha, kemi pasur edhe mërgatën që e mbajti gjallë rezistencën. Në fund, kur padrejtësia u bë e padurueshme, bijtë dhe bijat më të mira të këtij vendi filluan të ndërtojnë Ushtrinë Çlirimtare, në krye me komandantin Adem Jashari, duke zgjedhur sakrificën në vend të nënshtërimit. Dhe e dini që shtëpitë filluan të digjen. Shumë jetë të pafajshme u shuan, shumë masakra në Republikën e Kosovës. Mirëpo, shpirti i popullit tonë nuk u dorëzua asnjëherë dhe kjo kaloi nga fjala në pushkë. Jo sepse e donim luftën, por sepse u mohua e drejta për të jetuar të lirë. Fatmirësisht, liria jonë u ndërtua mbi tri shtylla të forta, mbi gjakun e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mbi qëndresën e qytetarëve dhe mbi besimin e palëkundër se Kosova një ditë do të bëhej shtet. Pas luftës, kjo liri, ky shtet u ndërtua nga vetë duart e këtij populli, nga vetë duart që ju i dini e sot janë prezent, nga mësimdhënës, nga policët, nga ushtarët, nga inxhinierët, nga lutjet e hoxhëllarëve, nga angazhimi i organizatave shtetërore dhe nga besimi i çdo qytetari që i dhanë subjekteve politike për t'u drejtuar këtë vend. Mirëpo, të nderuar të pranishëm, sot në këtë përvjetor t'i kujtojmë edhe ata që po përballen me padrejtësinë në Hagë, ish liderët tonë që gjenden atje duke besuar në drejtësi të pa anshme dhe në të vërtetën. Dhe sot, pikërisht në këtë Kuvend, në këtë sallë, në këtë takim, pavarësisht bindjeve politike që kemi, ne kemi një detyrë të përbashkët, ta ruajmë dhe ta forcojmë këtë shtet për fëmijët tonë, për të ardhmen tonë. Liria ka filluar me sakrificë, është fituar me gjak dhe mbahet gjallë vetëm nëse jemi të bashkuar dhe kemi unitet. Pra, liria nuk do të thotë edhe shteti nuk do të thotë që është vetëm himn dhe është vetëm flamur. Mirëpo, shteti do të thotë të ketë drejtësi. Shteti do të thotë të ketë punë, të ketë barazi për të gjithë. Siguri që askush mos ndihet i përjashtuar prej shtetit të vet. Dhe shteti, mbi të gjitha, nuk është vetëm ndërtesë që ne duhet ta mirëmbajmë, mirëpo është përgjegjësi, është moral, është guxim për ta thënë të vërtetën edhe kur nuk na pëlqen. Pra, është përgjegjësi e të gjithë neve sot që jemi prezent këtu, të nderuar anëtarë të Kuvendit dhe ju të pranishëm, që Kosovën ta bëjmë shtëpi për të gjithë. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit! Urime dita e Pavarësisë. Faleminderit që më dëgjuat. Tani, të nderuar të pranishëm, sipas rendit të ditës, më lejoni që ta ftojë në mungesë të Kryetarit të Komunës, ta ftoj Nënkryetarin e Komunës për një fjalë rasti. Nënkryetar, fjala është e juaja.

Pika 2

Fjalë rasti nga Nënkryetari i Komunës

Nënkryetari, z.Adnan Ademi: Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, i nderuar Kryesues i Kuvendit, z.Jakupi, të nderuar drejtor dhe zyrtarë komunal, të nderuara familje të dëshmorëve e martirëve të Luftës së UÇK-së, përfaqësues të shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, Kryetar i Bashkësisë Islame në Shtime, Skender Baftiu, Komandat i stacionit të Policisë në Shtime, z.Haxhi Behluli, media dhe shoqëri civile, të nderuar të pranishëm, të dashur bashkëqytetarë të Komunës së Shtimes, sot, me krenari dhe respekt të thellë, shënojmë 17 Shkurtin ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Kjo datë nuk është vetëm një ditë kalendarike, por përmbledhje e një rrugëtimi të gjatë sakrifice, përpjekjeje dhe qëndrese shekullore për liri dhe shtetësi. 17 Shkurti përfaqëson kurorëzimin e përpjekjeve të gjeneratave të tëra që nuk u dorëzuan asnjëherë përballë padrejtësisë. Është dita që simbolizon realizimin e aspiratës sonë për të qenë të lirë, të pavarur dhe zot të vendit

tonë. Në këtë ditë solemne, përulemi me nderim të veçantë para dëshmorëve të kombit, para familjeve që sakrifikuan më të dashurit e tyre, para veteranëve, invalidëve dhe luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kujtojmë me respekt çdo protestues, të burgosur politik, të përndjekur e të torturuar, çdo civil të pafajshëm që dha jetën në rrugën drejt lirisë. Ne si Komunë e Shtimes kemi dhënë kontribut të çmuar në këtë rrugëtim historik dhe do ta ruajmë gjithmonë me krenari kujtesën për secilën sakrificë. Kujtojmë sakrificën heroike të familjes Jashari dhe Masakrën e Reçakut, dhe çdo ngjarje që i parapriu çlirimit dhe shpalljes së Pavarësisë. Liria jonë nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e fuqishme të miqve tanë ndërkombëtarë, në veçanti të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve tanë, të cilët qëndruan pranë nesh në momentet më vendimtare të historisë sonë. Sot, ndërsa festojmë, nuk harrojmë as ata që po përballen me procese gjyqësore në Hagë. Ne besojmë në drejtësi, në procese të drejta dhe të paanshme, por njëkohësisht shprehim solidaritetin tonë me të gjithë ata që kontribuan në rrugën e lirisë dhe me familjet e tyre. Lufta e popullit të Kosovës ishte luftë për liri dhe dinjitet, dhe kjo e vërtetë historike mbetet e patjetërsueshme. Nga ne sot kërkohet përgjegjësi më e madhe. Shtetin që e kemi fituar me gjak dhe sakrificë duhet ta zhvillojmë me punë, ndershmëri dhe përkushtim. Çdo qytetar, pa dallim pozite, ka përgjegjësi në ndërtimin dhe avancimin e Republikës sonë. Synimi ynë është një Kosovë e zhvilluar ekonomikisht, me vende të reja pune për të rinjtë, me institucione të forta dhe me sundim të ligjit. Një shtet modern, demokratik dhe me perspektivë evropiane. Republika e Kosovës është realitet i pakthyeshëm. Është shtet sovran, i ndërtuar mbi sakrificë dhe mbi vlera demokratike. Ne do të vazhdojmë të punojmë për ta forcuar atë çdo ditë, duke ruajtur unitetin, dinjitetin dhe orientimin tonë strategjik. Le të na shërbejë ky përvjetor si moment reflektimi dhe angazhimi të ri për të ardhmen. Të ecim përpara së bashku, me respekt për të kaluarën dhe me besim të plotë në të ardhmen. Urime 17 Shkurti dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës! Lavdi dëshmorëve, lavdi martirëve të luftës! Respekt dhe mirënjohje familjarëve të tyre. Ju faleminderit.

Pika 3

Përfaqësues të subjekteve politike në Kuvend

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Faleminderit, z. Ademi. A dëshiron dikush nga anëtarët e Kuvendit të marrë fjalën? Nëse nuk kemi fjalë nga anëtarët e Kuvendit, atëherë kalojmë në pikën e katërt.

Pika 4

Përfaqësues nga OVL e UÇK-së

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: E ftojë një përfaqësues nga organizata e veteranëve të luftës, apo nga organizatat e luftës së UÇK-së të marrë fjalën. Nëse e ka dëshirën, Kryetari z.Muhamet Bilalli.

Kryetar i SHFD, z.Muhamet Bilalli: I nderuari, kryetar i Bashkësisë Islame, komandant i Policisë, komandant të nderuar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të gjithë të pranishëm dhe veçanërisht e kemi këtu edhe njeriun që ka hjekur shumë që është baci Isak, ku të gjithë kemi dhënë ngapak për liri, mirëpo ky dha gjithçka çka kishte, për më ardhë deri këtu ku jemi sot. Këtë ditë feste, që sot jemi mbledhur këtu, në këtë sallë, unë jamë i kënaqur, që ju shoh të gjithë të bashkuar, sepse edhe dëshmorët edhe martirët edhe të gjithë luftëtarët nuk e patën asnjë synim partiak, por patën synim bashkimit të gjithë shqiptarëve. Edhe ne në shoqatat tona të luftës, kërkojmë nga të gjithë ju bashkim, e sidomos kur janë në pyetje çështjet kombëtare, për çështjet e mëdha duhet të bëhemi të gjithë bashkë, të jemi sikurse një. Ne nuk jemi armiq mes veti, pa marrë parasysh që mund të jemi

kundërshtarë politik. Mirëpo kur e kemi 17 Shkurtin, pastaj tash po na vjen edhe epopeja e UÇK-së, pesë, gjashtë, edhe shtatë marsi dhe le të jemi të unifikuar për hatër të atyre që dhanë gjithçka, që e dhanë jetën për ne dhe sot po e gëzojmë këtë liri. Urime juve të gjithëve, urime qytetarëve të Shtimes dita e Pavarësisë. Në veçanti urime presidentit Hashim Thaçi, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, që po mbahen padrejtësisht qe pesë vite dhe po gjykohen në një gjykatë naciste. Kur ne sot po festojmë, ata po përballen në gjykatë pikërisht me 17 Shkurt, ata po përballen me padrejtësi që po ju bëhet. Urime të gjithëve dita e Pavarësis, lavdi dëshmorëve e martirëve, të gjithë atyre që sakrifikuan për këtë liri. Faleminderit.

Kryesuesi, z.Rrahman Jakupi: Faleminderit, kryetar Bilalli. Të nderuar të pranishëm, me kaq konsideroj të mbyllur seancën solemne për 17 Shkurtin, ditën e Pavarësisë, duke ju uruar secilit shëndet fillimisht, dhe të kaloni festën sa më mirë. Po ashtu, sot mbahet një protestë, kush keni mundësi me na u bashkangjit në këtë, realisht me ju bashkangjitë platformës, “Liria ka Emër” do ishte e mirëseardhur. Mirupafshim në takimin e radhës. Faleminderit shumë. Mbledhjen e përfundoi në ora 09:20h.

Procesmbajtëse:
Sadbere Halili

Sadbere Halili



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi

Rrahman Jakupi